



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:277802

Datë: 12.01.2024

Numri i dokumentit: 05184618

AA.nr.107/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar i kolegjit, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë të kolegjit, në konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit A... J. Sh... nga Prishtina, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1207/2019 të datës 19.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit A... J. Sh.. nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1207/2019 i datës 19.12.2022, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1207/2019 të datës 19.12.2022, është hedhë poshtë si e parakohshme padia e paditësit A... J. Sh... nga Prishtina, për anulim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 06/99 i dt.23.04.2019, lënda me shenjën e evidencës A. nr.1207/2019, e dt. 22. 05. 2019.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi për shkak së: nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore, në procedurë që i ka paraprirë aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike. Me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit, të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje padia e paditësit A... Sh..., për anulimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.06/99 i datës 23.04.2019, përkatësisht lënda 1207/2019.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, si dhe nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi me datën 22.05.2019, për anulimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.06/99 i dt. 23.04.2019. Me padi ka kërkuar nga gjykata të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkespadija e paditësit, të anulohet vendimi i të paditurës nr.06/99 i dt. 23.04.2019 dhe të rishpallet konkursi për pozitën Zevendësdrejtor/eshë për shërbime operative në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajrori-ASHNA të Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë përmes aktvendimit A.nr. 1207/2019, të dt. 28. 10. 2021, e ka obliguar paditësin që të paraqet dëshminë për shterrjen e mjeteve juridike në procedurë administrative, por i njëjti përmes parashtresës së dorëzuar në gjykatë më dt. 27.04.2022 këmbëngulë që ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës Nr.06/99 të dt. 23.04.2019 ndaj të cilit nuk ka të drejtë ankesë, prandaj kërkon nga gjykata që pas pranimit të parashtresës të merr vendim në mënyrë meritore.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë, përfshirë edhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nuk kishte mundësi të konstatoi si të provuar faktin se paditësi, i ka shterrur mjetet e brendshme në procedurë administrative, për të fituar të drejtën që të inicioj konfliktin administrativ në këtë gjykatë. Gjykata e shkallës së parë konsideron se paditësi duke i respektuar dispozitat dhe afatet ligjore, është dashur që fillimisht të paraqesë ankesë në KMPSHCK ndaj vendimit të Komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave të dt. 10.05.2019 me nr.3660.

Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së padisë në gjykatë, gjykata e shkallës së parë iu referua Ligjit për Procedurën Administrative nr. 05/L-031, nenit 124.6 të të njëjtit, i cili përcakton se: *“Shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt, përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Përgjashtimisht, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë e nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, në keto raste: 6.1. nuk ekziston organi epror; 6.2. palës së tretë i janë cenuar të drejtat apo interesat juridike nga akti administrativ që zgjidh ankesën, apo 6.3 parashikohet*

shprehimisht me ligj. Poashtu gjykata e shkallës së parë ju referua edhe Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës neni 16.1, si dhe ka bërë shikim në Aktgjykimin nr. KO171/18, Publikuar më dt. 29.05.2019 - tek Aktgjykimet-Gjykata Kushtetuese e Kosovës, më ç'rast ka gjetur se neni 16.1 i Ligjit nr. 06/L-048 përcakton: “Nëpunësi civil, apo kandidati për praninë në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshill, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës”. Mbështetur në të njëjtin nen 16.4. thuhet: “Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.

Gjithashtu gjykata e shkallës së parë iu ka referuar edhe Ligjit për Konfliktet Administrative, Nr. 03/L-202 përkatësisht nenit Neni 13.1, ku shprehimisht përcaktohet: “Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë”, si dhe Ligjit për Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149, nenit 81.1 që përcakton se: “81.1. Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave themelohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e kontesteve dhe pranimit të ankesave. 81.2. Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës”. Pas shqyrtimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë gjeti se paditësi ka parashtruar ankesë kundër Komisionit Përzgjedhës “ad hoc” të Shërbimit Civil për Pozitën: Zevendësdrejtor/esh për Shërbime Operative në Agjencinë për Shërbime të Navigacionit Ajror me datë 10.04.2019. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit ka nxjerrur vendim me datë 10.05.2019 me këshillë juridike ku i ka dhënë të drejtën palës paditëse që të njëjtin vendim ta atakoj në afat prej 30 ditëve në KPMSHCK. Për kundër kësaj nga shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet se ekziston ankesa në shkallë të dytë kundërshtimit të organit administrativ të nxjerrë në shkallë të parë. Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se, paditësi nuk i ka shterrë mjetet e ankimit në procedurën administrative, kusht ky ligjor sipas dispozitave të sipër cituara, për të fituar pastaj të drejtën që të ushtrojë padi në këtë Gjykatë. Mbi këto arsye gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 34.1.1. të Ligjit për Konfliktet Administrative, padinë e paditësit e hedhë poshtë si të parakohshme, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj, në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktvendimi i ankimit nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se paditësi duke i

respektuar dispozitat dhe afatet ligjore, është dashur që fillimisht të paraqesë ankesë në KMPSHCK ndaj vendimit të Komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave të dt. 10.05.2019 me nr.3660. Pra të veproj si në vështrim të nenit 124.6 të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 05/L-031, i cili përcakton se: *“Shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt, përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës neni 16.1 i cili përcakton se: “Nëpunësi civil, apo kandidati për pranim në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshill, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës”. Ligjit për Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149, neni 81.1 që përcakton se: “81.1. Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave themelohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e kontesteve dhe pranimin e ankesave. 81.2. Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës”.*

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, me të drejtë ka konstatuar se paditësi ka parashtruar ankesë kundër Komisionit Përzgjedhës “ad hoc” të Shërbimit Civil për Pozitën: Zevendësdrejtor/esh për Shërbime Operative në Agjencinë për Shërbime të Navigacionit Ajror me datë 10.04.2019. Ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit ka nxjerrur vendim me datë 10.05.2019 me këshillë juridike ku i ka dhënë të drejtën palës paditëse që të njejtin vendim ta atakoj në afat prej 30 ditëve në KPMSHCK. Për kundër kësaj nga shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet se ekziston ankesa në shkallë të dytë kundërshtimit të organit administrativ të nxjerrë në shkallë të parë. Prandaj, nga të lartcekurat rezulton se paditësi nuk ka shtjerr mjetet juridike para organeve administrative në afat ligjor, pra nuk i ka shtrë mjetet e ankimit në procedurën administrative, kusht ky ligjor sipas dispozitave të sipër cituara, për të fituar pastaj të drejtën që të ushtroj padi në këtë Gjykatë.

Pretendimet ankimore të paditësit se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes, nga faktet e vërtetuara ka nxjerr një konkluzion jo të drejtë, duke aplikuar pastaj gabimisht dispozitat ligjore dhe në këtë mënyrë duke kërkuar nga paditësi iniciimin e një procedure tjetër paraprake që në fakt për paditësin në asnjë formë nuk ka qenë e mundur të realizohet. Përkundrazi nëse i njëjti nuk do të atakonte vendin e Qeverisë sipas padisë që ka parashtruar, ai do të penalizohej pasi që më tej do të pamundësohej parashtrimi i padisë ndaj vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës si vendim i shkallës së parë, por pa të drejtë ankese, për çka edhe i njëjti ka iniciuar konflikt administrativ në përputhje me nenin 13 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, dhe të paqëndrueshme. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktvendimi i ankimit i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Ngase paditësi nuk ka shtjerrë mjetet juridike para organeve administrative, e që pastaj ti drejtohen gjykatës në konfliktin administrativ me padi ashtu siç është përcaktuar me dispozitat

e lartcekura të LKA-së. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se aktvendimi i ankimuar është marrë duke respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale, konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatim të drejtë të së drejtës materiale.

Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve, kolegji vlerëson se në këtë çështje juridike administrative drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar çështja lëndore në gjykatën e shkallës së parë dhe nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj, ankesa refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga sa u tha më lartë, e në vështrim të nenit 49 të LKA-së, kolegji vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 209 pika b) të LPK-së të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.107/2023, më datë 05.01.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi